

*Specialist në Sektorin e Akreditimit dhe Politikave, Drejtoria e Certifikimit Elektronik dhe Kontrollit, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike*

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Aktit Normativ të miratuar nga Këshilli i Ministrave, Nr.15, Datë 13.10.2022, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9880, Datë 25.02.2008, “Për Nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, VKM-së Nr.141, datë 22.02.2017 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist në Sektorin e Akreditimit dhe Politikave, Drejtoria e Certifikimit Elektronik dhe Kontrollit, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike**

**DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

a) Pranon dhe kontrollon dokumentacionin e paraqitur nga subjektet te cilet kërkojne te regjistrohen si Ofrues te kualifikuar të Sherbimeve te Besuara

b) Raporton mbi konformitetin e dokumentacionit ligj or dhe teknik te dorezuar nga Ofruesi i Kualifikuar i Sherbimit te Besuar sipas kritereve te Autoritetit, Direktivave Evropiane, Normave Evropiane dhe Standardeve Teknike te ETSI (European Telecommunication Standarts)

c) Kontrollon dokumentacionin e dorezuar per pajisjet e sigurta te krijimit te nenshkrimit (secure signature-creation devices), dhe certifikatat e ldshuara nga prodhuesi i tyre ne menyre qe te plotesohet niveli European i sigurise EAL3+

d) Kontrollon per plotesimin e kritereve te Certif,rcate Policy, Certificate Practice Statement, Manualit Operativ dhe Time-Stamping

e) Harton dhe pershtate specifikime teknike sipas standardeve nderkombetare, si dhe jep kontribut ne bashkepunim me institucionet e dera, ne fushen e nenshkrimit elektronik, identifikimit elektronik dhe sherbimeve te besuara si dhe ne fushen e sigurise kibernetike

**KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

- Te zoteroje diplome te nivelit Master Profesional, ne Shkenca Inxhinieri Informatike/Kompjuterike/Elektronike
- Të ketë të paktën 1 (një) vit eksperience pune;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Të ketë aftësi shumë të mira në analizimin dhe zgjidhjen e problemeve në kohë reale;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të bashkëpunimit në grup;

- Përparësi certifikime profesionale në: Çertifikatë për menaxhim dhe administrim rrjetesh lëshuar nga kompani lider në fushën e rrjeteve kompjuterike, Certifikata në fushën e sigurisë së informacionit, Certifikata njohje të programeve kompjuterike, Certifikata në fushën reverse malware engineering etj

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (III-b)**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 08.11.2022, në adresën e e-mailit: [burimet.njerezore@cesk.gov.al](mailto:burimet.njerezore@cesk.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të çertifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t'u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.